



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT TË LARTË DHE  
KËRKIMIT SHKENCOR  
DREJTORIA E POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT TË KËRKIMIT SHKENCOR

Nr. 5988/2 prot.

Tiranë, më 24.10.2024

Lënda: 2 Përcillen kriteret e shpalljes për përfitimin e bursave në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor

**UNIVERSITETIT TË TIRANËS**

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.3, Tiranë

**UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS**

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza" Nr. 4, Tiranë

**UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË**

Adresa: Rruga e Dibrës, Nr. 371, 1005, Tiranë

**UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS**

Adresa: Rruga "Pajsi Vodica", Kodër Kamëz, Tiranë

**UNIVERSITETIT TË ARTEVE, TIRANË**

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 2, Tiranë

**UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS**

Adresa: Rruga "Muhamet Gjollesha", Tiranë

**UNIVERSITETIT TË SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"**

Adresa: Sheshi "2 Prilli", nr. 24, Shkodër

**UNIVERSITETIT TË ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**

Adresa: Rruga "Ismail Zyma", Elbasan

**UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË**

Adresa: Skelë, Rruga "Kosova", 9401, Vlorë

**UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË**

*Adresa: Bulevardi "Rilindasit 1", Korçë*

**UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTËR ✓**

*Adresa: Rruga "Studenti 30", Gjirokastrë*

**UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS**

*Adresa: Rruga "Currila", nr.14, 2001, Durrës*

*Të nderuar Rektorë,*

Në zbatim të ligjit nr. 23/2024 "Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", gjeni bashkëlidhur kriteret e përcaktuara për shpalljen për përfitimin e bursave sipas përcaktimeve të kësaj marrëveshje.

Shpallja e kësaj thirrje të realizohet në faqen zyrtare të institucioneve tuaja 3 ditë brenda marrjes së këtij njoftimi.

Procedurën dhe detajet e administrimit të këtij procesi i gjeni në materialin bashkëlidhur kësaj shkrese.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**Erzen Tola**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Ministria e Arsimit dhe Sportit, duke u mbështetur në ligjin nr. 23/2024 "Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor".

Shpall kriteret  
për ndarje të bursave për studentët nga Republika e Kosovës, në universitetet publike në  
programet bachelor për vitin akademik 2024-2025

**Kushtet dhe kriteret**

Të drejtë për bursë kanë të gjithë studentët në nivelin Bachelor që studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë në Shqipëri, nga Republika e Kosovës të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara:

**Kriteret e aplikimit për vitin e parë Bachelor:**

- 1 Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës
- 2 Të jenë të regjistruar për herë të parë në një program Bachelor në një IAL publike në Shqipëri për vitin akademik 2024-2025
- 3 Të kenë notë mesatare të studimeve të arsimit të mesëm të lartë së paku 7 (Vendimi nr. 363, datë 26.5.2022 "Për një shtesë në Vendimin nr. 436, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim", të ndryshuar)  
(Për programet e studimit në fushat arte dhe sporte nuk aplikohet kriteri i mesatares i cituar më lart)

Në raste të mosplotësisimit të kuotave për studentët e regjistruar për herë të parë në vit të parë në vitin akademik 2024-2025, kuotat do të akordohen për vitet e tjera të studimit.

**Kriteret e aplikimit për vitet e ndërmjetme:**

- 1 Të ketë përfunduar vitin e parë ose të dytë të nivelit Bachelor
- 2 Të mos kenë vit të përsëritur të studimeve
- 3 T'i ketë përfunduar të gjitha provimet e vitit akademik paraprak të përcaktuar me program studimor dhe në afat kohor të rregullt